



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 22.03.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 18.03.2021 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Kompania Prishtina SHPK" për aktivitetin: "Ndertimi i shkolles "Nene Tereza" ne Vranidoll" dhe me numër të prokurimit: 616 -20-8105-521 nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "Kompania Prishtina SHPK" e datës 18.03.2021 lidhur me aktivitetin e prokurimit " "Ndertimi i shkolles "Nene Tereza" ne Vranidoll" dhe me numër të prokurimit: 616 -20-8105-521 kundër *Njoftimit per Vendimin e Autoritetit Kontraktues* të datës 15.03.2021, te publikuar ne web-faqe te KRPP-së.
2. Vërtetohet *Njoftimi i Autoritetit Kontraktues* i publikuar me datë: 15.03.2021;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj respektimin e Vendimit te dates 15.03.2021*
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "Kompania Prishtina SHPK" me datë 18.03.2021 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: " "Ndertimi i shkolles "Nene Tereza" ne Vranidoll" dhe me numër të prokurimit: 616 -20-8105-521.

Autoriteti Kontraktues, me datë 22.03.2021, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:


-Pretendimi juaj është i pa bazuar për faktin se sipas Rregullave për tenderet jonormalisht të ulët, asnjë nga tenderet e dorëzuar nuk mund të klasifikohet si i tillë, pra as tenderi i OE-ik të rekomanduar për dhenje të kontratës. Poashtu komisioni profesional nuk ka dhënë asnjë vërejtje të veçantë lidhur me çmimet për artikujt që ju i keni çekur në kërkesën tuaj. Poashtu bazuar në çmimi total të rekomanduarit për kontratë dhe tenderit tuaj rrjedh se dallimi është shumë i ulët në krahasim me vlerën totale dhe çmimin tuaj.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne sqarimet e paraqitura më larte vendosi si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit